

Faruk KOKA

UDHË TË MBARË, KOLANËS ETNOKOREOGRAFIKE TË PROF. DR. RAMADAN BOGDANIT!

Kohët e fundit, nga një kolanë botimesh etnokoreografike doli nga shtypi vëllimi I “Etnokoreografi” me autor prof. dr. Ramazan Bogdani. Ky vëllim përfshin lëndën e pasqyruar në një hapësirë 15-vjeçare, nga 1965- 1979. Gjithashtu, në këtë libër janë publikuar edhe 34 artikuj të mëvetsëm, shumica e të cilëve shohin dritën e botimit për herë të parë. Pra, lënda e këtij vëllimi vjen nga dy drejtime kryesore:

Së pari, nga artikuj të botuar, që kanë marrë një dimension të ri, përcaktuar nga ngjeshja e lëndës apo pasuruar me detaje të patrajtuara më parë.

Së dyti, nga artikuj që publikohen për herë të parë, të cilët nuk janë botuar për arsye të ndryshme.

Në rrafshin e trajtesave të raporteve të lëndës midis arealit të tradicionales dhe bashkëkohores, përparësi ka e para, si më e hershme për nga tharmi popullor dhe origjinaliteti i spikatur. Për këtë gjykojmë se është pasur parasysh edhe parimi metodologjik se, studimi i së hershmes i shërben edhe të tashmes edhe të ardhmes.

Artikujt e këtij vëllimi ceken përgjithësisht sipas disa grupimeve specifike. Këto vijnë nga:

- 1) Gjurmime të ekspeditave në terren.
- 2) Festalet folklorike lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare.
- 3) Instikte njësisht koreografike.
- 4) Refleksione kumtesash.
- 5) Referime relacionesh.
- 6) Koleksione dokumentacionesh.

7) Makroartikuj studimorë.

8) Ngrehinë vëllimesh etnokoreografike.

Gjatë periudhës 1965-1979, për grupimin e parë, janë realizuar dymbëdhjetë ekspedita shkencore në terren (Shqipëri dhe Kosovë) kryesisht për probleme të koreografisë popullore. Sipas rendit kronologjik, të tilla janë: 1. Ekspedita në Zall-Dardhë të Peshkopisë (1964); 2. Ekspedita e parë në rrethin e Kukësit (1968); 3. Ekspedita e dytë në rrethin e Kukësit (1969); 4. Ekspedita në fshatrat Dardhë-Sinicë-Qytezë të rrethit të Korçës (1969); 5. Ekspedita në fshatra të Hasit të Shqipërisë (1970); 6. Ekspedita komplekse në fshatrat e krahinave Rrëzë dhe Dishnicë të rrethit të Përmetit (1971); 7. Ekspedita në Rrafshin e Dukagjinit të Kosovës (1972); 8. Ekspedita në fshatin Shënkoll të rrethit të Lezhës (1972); 9. Ekspedita në fshatra të rrethit të Shkodrës (1972); 10. Ekspedita në fshatra të Lunxhërisë së Gjirokastrës (1975); 11. Ekspedita në fshatra të krahinës së Mokrës së Pogradecit (1975); 12. Ekspedita në fshatra të Luginës së Shkumbinit të rretheve Librazhd dhe Elbasan (1976). Duhet theksuar se në disa prej këtyre ekspeditave, autori i ka realizuar edhe me bashkëpunëtorë të tjerë.

Në periudhën gjatë viteve 1965-1979 janë realizuar edhe tre ekspedita të tjera: në Dibër (1977); te kosovarët e rrethit të Durrësit (1979); në Rugovë dhe Opojë të Kosovës (1979). Kërkimet në të pesëmbëdhjetë ekspeditat janë përqendruar në rreth 100 fshatra, të cilët i përkasin rretheve Dibër, Lezhë, Kukës, Pogradec, Korçë, Përmet, Gjirokastrë, Librazhd, Elbasan dhe disa viseve në Kosovë.

Një zë të fuqishëm në "Etnokoreografi I", përbëjnë shkrimet e grupimit të dytë mbi festivalet folklorike. Tregues për këtë janë gjashtë artikuj, nga të cilët dy për festivalet e rretheve, tre për festivalet kombëtare dhe një për festivalin ndërkombëtar.

Lidhur me festivalet folklorike të rretheve, janë: "Festivali folklorik i rrethit të Kukësit (1968) dhe "Tribuna të gjalla të gurrës popullore shqiptare" (Mbresa nga festivalet folklorike të rretheve Tropojë dhe Korçë (1973). Në shkrimet për këto festivale vihet në dukje gjallëria e krijimtarisë tradicionale dhe bashkëkohore e fshatrave, zonave dhe krahinave të të tre rretheve përfaqësuese.

Në vijim të trajtesave të lëndës në "Etnokoreografi I", për

grupimin e tretë, profesor Bogdani ka përzgjedhur dy shkrime për valle të veçanta, të përcaktuara si instinkte njësisht koreografike. Ato janë: "Ojna e lepurit", një krijim i bukur folklorik koreografik dhe një valle e lashtë shqiptare "Vallja e fëllënxave". Ndonëse e para është sjellë nga ekspedita në luginën e Shkumbinit (1976) dhe e dyta nga kërkimet në Lezhë (1973), ato përbëjnë dy njësi koreografike që, për nga tematika dhe struktura, i përkasin të njëjtit lloj të gjinisë lirike, pikërisht valleve pantomimë.

Grupin e katërt të lëndës së trajtuar, e përbëjnë artikujt për fushën e koreografisë popullore, të përcaktuar si refleksione kumtesash. Këto nuk i referohen drejtpërsëdrejti kumtimit, por kryesisht botimit të plotë ose të pjesshëm të tyre. Nga tetë të përzgjedhurat, gjashtë janë mbajtur gjatë periudhës 1965-1979, kurse dy të tjerat, tërësisht ose pjesërisht, sipas njësimi me lëndët përkatëse.

Grupim e pestë e përbëjnë shkrimet, të përcaktuara si referime relacionesh. Dimensionet e këtyre relacioneve rrokin komunikime me vlera universale nga fusha e folklorit në tërësi dhe e koreografisë popullore në veçanti.

Në fokusin e problematikës dhe faktologjisë, kjo monografi vijon me një syth, siç është grupimi i gjashtë "Koleksione dokumentacionesh". Ndonëse me vlerësime të skajshme, ky grupim është i domosdoshëm për nga rëndësia etnokoreografike.

Shkrimet për këtë spektër i bëjnë jehonë kryesisht punimit të disertacionit "Vallet e Lunxhërisë...", në rrafshin e mbrojtjes në sektorin e muzikës e të koreografisë.

Artikujt studimorë nga fusha e koreografisë popullore, të përcaktuar si makroartikuj, të cilët përfshihen në grupimin e shtatë të librit "Etnokoreografi I", sigurisht përbëjnë një arritje të madhe shkencore. QË në titull zbulohet se në të tetë artikujt studimorë, rroket problematikë me karakter krahinor dhe kombëtar. Në këtë hulli, përkatësisht me trajtesë vallesh nga krahina të ndryshme të Shqipërisë, rrezatojnë kultura koreografike të kamotshme dhe njëkohësisht, bashkëkohore. Për nga origjina, repertori, emërtimet, përmbajtja, struktura dhe më gjerë, ato i nënshtrohen analizave morfologjike, me veçori specifike, por edhe me ngjashmëri tipologjike për nga homogjenizimi kombëtar.

Periudhës 1965-1979 i përkasin edhe botimet e plota të katër librave me lëndë nga fusha e etnokoreografisë, që përfshihen në grupimin e tetë dhe janë përcaktuar si ngrehinë vëllimesh. Ato janë: “Të njohim vallet tona popullore”, “Në truallin e valles popullore”, “Folklori koreografik i Hasit” dhe “Shpirti i popullit në valle”.

Aparati shkencor dhe ilustrativ në vëllimin “Etnokoreografi I”, është përbërë nga 131 fotografi. Pjesë përbërëse janë edhe pesë notizime muzikore. Në vijimësinë për aparatin shkencor, ndonëse përciptazi, është paraqitur edhe ndonjë transkriptim koreografik.

Burimet fotografike vijnë nga dy drejtime: Së pari, nga Fotofilmoteka e AIKP (Arshiva e Institutit të Kulturës Popullore); së dyti, nga arkivi vetjak i autorit.

Emrat e bashkautorëve dhe bashkëpunëtorëve të artikujve përkatës dhe organeve botuese, sigurisht që citohen veçmas në çdo artikull, sikundër po kështu veprohet edhe për të tjerët me karakter vetjak, që përbëjnë shumicën në këtë vëllim.

Këtu ka vend të vlerësohet puna e madhe dhe e përkushtuar, që ka kryer Sektori i Teknikës së IKP-së, në drejtim të zbardhjeve muzikore, filmike dhe pjesërisht fotografike të disa proceseve të karakterit laboratorik.

Ashtu si edhe në botimet e tjera që mbajnë për autor profesor Ramazan H. Bogdani, një vend i veçantë i kushtohet edhe përmbledhjes në gjuhën angleze. Kjo mundëson që vlerat e kulturës popullore shqiptare të njihen dhe të bëhen pasuri edhe e studiuësve dhe bibliotekave të vendeve të ndryshme të botës, me të cilat autori mban një korrespondencë të rregullt.